



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
26.01.2026

Me datë 26.01.2026, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Jona Leqejza, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Gëzim Galiqi, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Gjovalin Ndoj, Florian Bjanku, Irena Shala, Valjeta Bajraktari, Artan Haxhi, Gjenarin Kapcari, Elis Doci, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Imeldi Sokoli, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Sead Jushta, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Muharrem Shkaj, Daniela Jakoja, Mirsad Basha.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2025".*
2. *Projektvendim: " Për miratimin e Kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6 %) për ndihmën ekonomike".*
3. *Projektvendim: "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Znj. Daniela Jakoja".*
4. *Projektvendim: "Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër".*
5. *Projektvendim: "Për miratimin e shitjes të mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik si automjet në terësi, si dhe automjeteve dhe materialeve që përmbajnë hekur me procedurë ankandi publik për skrap".*
6. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit*

të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar ”.

7. *Projektvendim: “ Për një ndryshim në VKB nr.18 datë 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Nësia administrative Gur i Zi, fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Voltalia Albanie” i ndryshuar.*
8. *Projektvendim: “Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore “Rosek Rrjoll” Bashkia Shkodër”.*
9. *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
10. *Raport mbi punën e Këshillit Bashkiak për 12 - muajin e vitit 2025.*
11. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z. Luli bën leximin e rendit të ditës, dhe shton se rendit të ditës do i shtohen edhe dy pika:

1. *Projektvendim: “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2026”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e projektit “Sunny Schools”, të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA dhe Bashkia Shkodër, i cili përfshin instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Salo Halili” dhe “Ndoc Mazi”.*

Fjalën e merr **Z.Bjanku** për procedurë lidhur me mos-përfshirjen në rendin e ditës të dy projekt-rregulloreve:

- “Për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”;
- “Për kriteret dhe procedurat e vendosjes së emërtimeve të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Shkodër”.

Së pari, prej një kohe të gjatë, ne, anëtarët e grupit të punës të ngritur me vendim të Këshillit Bashkiak, kemi kërkuar përfshirjen e këtyre dy projekt-rregulloreve në rendin e ditës. Puna e grupit ad - hoc ka përfunduar prej më shumë se një viti. Megjithatë, në mënyrë të përsëritur janë gjetur arsye dhe justifikime të ndryshme për të mos i përfshirë për shqyrtim.

Së dyti, këto projekt-rregullore janë produkt i një procedure formale të miratuar nga vetë Këshilli Bashkiak dhe lidhen drejtpërdrejt me kompetenca ligjore ekskluzive të këtij organi, konkretisht dhënien e titujve vendorë të nderit dhe emërtimin e hapësirave dhe objekteve publike. Proceduralisht, ato duhej të ishin futur në rendin e ditës që në momentin e dorëzimit.

Së treti, mungesa e disa akteve nënligjore ishte e njohur që përpara ngritjes së grupit të punës. Kjo mungesë nuk e pezullon ligjin, nuk i pezullon kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe nuk mund të përdoret si justifikim për bllokimin e procedurës së miratimit të rregulloreve. Përkundrazi, kjo

situatë e bën edhe më të domosdoshëm miratimin e rregulloreve vendore, me qëllim zbatimin praktik të ligjit.

Së katërti, Drejtoria Juridike ka rol këshillimor dhe teknik, jo rol vendimmarrës. Ajo nuk ka kompetencë vetoje ndaj vullnetit normativ të Këshillit Bashkiak. Çdo vërejtje juridike trajtohet gjatë shqyrtimit përmes amendimeve dhe nuk mund të justifikojë mos-futjen e projekt-akteve në rendin e ditës.

Së pesti, nuk është e pranueshme që ushtrimi i një kompetence ligjore të Këshillit Bashkiak të pezullohet nga një shkresë e administratës, e ardhur me vonesë pas më shumë se një viti, e përcjellë vetëm si kopje e skanuar dhe pa asnjë akt formal vendimmarrës.

Së gjashti, mbajtja e këtyre projekt-rregulloreve jashtë rendit të ditës sjell pasoja konkrete: pezullohet në praktikë dhënia e titujve vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër; pezullohet emërtimi i rrugëve, shesheve dhe objekteve publike; pezullohet ushtrimi i dy kompetencave bazë të Këshillit Bashkiak; krijohet precedent që administrata të diktojë rendin e ditës së Këshillit; cenohet autonomia vendimmarrëse e këtij organi; forcohet arbitrariteti dhe mungesa e transparencës; dëmtohet politika publike e kujtesës, nderimit dhe identitetit të qytetit.

Së shtati, nëse një drejtori e administratës përcakton se çfarë hyn ose nuk hyn në rendin e ditës, kemi përmbysje rolesh institucionale, ku organi i zgjedhur kontrollohet nga struktura vartëse, duke u cenuar autonomia e Këshillit Bashkiak dhe parimi i vetëqeverisjes vendore.

Në përfundim, Këshilli Bashkiak ka të drejtën dhe detyrimin ligjor t'i shqyrtojë këto dy projekt-rregullore. Nëse ato nuk vlerësohen të përshtatshme, Këshilli ka instrumentin normal demokratik për t'i rrëzuar me votë. Por ato nuk mund dhe nuk duhet të mbahen jashtë rendit të ditës

Z.Luli, faleminderit, zoti Bjanku, në emër të kujt e bëni këtë deklaratë? Sepse ju si grup keni dorëzuar një draft rregullore. Draft rregullorja nuk është projekt vendim, zoti Bianco.. Draft rregullorja është një draft i cili i paraqitet për shqyrtim. Pra, drafti përmirësohet nga propozime dhe nga ndryshime dhe ti e di gjithë procedurën, e cila ndiqet për të sjellë një projektakt në Këshillin Bashkiak. Pra, a ka kaluar në komisionet përkatëse.? A e keni çuar te komisioni i çështjeve ligjore? A e keni çuar tek komisioni i emërtesave? Unë si kryetar Këshilli, përsa i përket këtyre dy draft rregulloreve i kam përcjellë për mendim zyrës juridike dhe nga ana e zyrës juridike ka ardhë vlerësimi ligjor përsa i përket dy draft rregullorëve që ju keni hartuar për të vazhduar me procedurën tjetër dhe janë komisionet përkatëse, të cilat kanë të drejtë për të hartuar projekt vendimet. Sepse të drejtën për të sjellë, projekt akte e ka Kryetari i bashkisë, e kanë grupet e këshilltarëve, qoftë edhe ato politike. E kanë deputetë, e kanë nismat qytetare dhe kështu me radhë. Unë nuk bëj pjesë te asnjëra prej këtyre.

Znj.Gjekaj merr fjalën duke u shprehur: Unë jam pjesë e komisionit në fjalë. Tani doja të sqaroja, sepse po dëgjoja me vëmendje diskutimin që po bëhej. Unë jam dakord me Zotin Bjanku. Draft rregullorja është njësoj sikur të jetë një projekt akt, i cili vjen në këshillin bashkiak, pasi ju keni marrë vendimin dhe ia keni dërgu zyrës juridike për të dhënë një mendim, sepse e keni bërë për të përjashtuar zyrën juridike, sepse e keni cilësuar si një projekt akt dhe nuk keni respektuar nenin shtatëdhjetë të rregullores mbi të cilën ne si Këshill funksionojmë. Neni shtatëdhjetë i rregullores,

ju detyron që ju të dërgoni projektaktet apo iniciatat, propozimet e subjekteve të parashikuara në ligj që kanë të drejtën për ta bërë, që mos të bëjmë në përsëritje, për t'i dërguar për t'u dhënë një mendim zyrës juridike. Në këto kushte, ju de facto dhe de jure e keni pranuar që është një projektakt aq më tepër që komisioni ad-hok i përbërë nga shtatë anëtarë është ngritur me vendim të Këshillit bashkiak, pra hartimi i draft rregulloreve nuk është thjesht një propozim, një iniciativë e një këshilltari apo dy, tre këshilltarëve apo dhjetë këshilltarësh, por është një komision i ngritur me votë, i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak për një qëllim të caktuar. Në kushtet që ju ja keni përcjellë për mendim zyrës juridike, zyra juridike ka patur afatat për këtë dhe nuk e ka respektuar. Ta thotë sepse shkresa që ju keni vënë në dispozicion me rrugë elektronike daton me datën katërmëdhjetë janar dhe në kushtet kur nuk respektohet afati, dhjetë ditëshi nga administrata e Bashkisë, merret e mirëqënë që ai projekt akt, në këtë rast, draft rregullorja miratohet dhe normalisht ju si kryetar Këshilli duhet ta kaloni tek komisionet e Këshillit. Dhe si të jetë vendimi i komisionit, më pas do kalohet për miratim nga të gjithë anëtarët. Tani draft rregulloret, janë të hartuara, ashtu siç e kërkon legjislacioni në fuqi, dhe mendimi i zyrës juridike, prandaj siç e tha zoti Bianku, nuk mundet askush të pezullojë apo të ndalojë procedurën e diskutimit në komisione, apo më pas edhe sjelljes në Këshill për miratim të këtyre draft rregulloreve. Ata kanë dhënë një mendim të tyrin, janë të mirëpritur për ta dhënë, por administrata e Bashkisë nuk ka një rol kontrollues apo fuqi mbi vendimet që merr Këshilli bashkiak, sepse jemi dy institucione të ndara nga njëri-tjetri. Në këto kushte, unë theksoj që ato draft rregullore, ju si kryetar i Këshillit duhet të na i vini në dispozicion tek komisionet, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të jenë pjesë e rendit të ditës dhe pastaj të diskutojmë dhe të shohim se si do të vendosin anëtarët për miratimin.

Znj.Shllaku: Për procedurë, atëherë edhe unë jam pjesë e komisionit të ngritur përse i përket dhënies së titujve të nderit apo emërtesat dhe është shumë e rëndësishme të kuptojmë diçka, kryetar. Qytetarët sot kanë të drejtën e informimit. Ato duan të dinë pse domethënë këto tituj nuk po vijnë në Këshillë, pra si projekt vendime? Dhe do kisha kërkuar, që të paktën të jenë të gjithë të përgjegjshëm për atë çfarë po flasim. Ne nuk po kërkojmë të gjejmë fajtorin, por duam ti japin rrugë kësaj çështjeje, sepse marr shumë shqetësime nga qytetarët që kanë vite që kanë dorëzuar dokumentacionin dhe nuk po jejnë zgjidhje. Pra këto rregullore duhet të paraqiten në Këshill për të kaluar edhe fazën e aprovimit.

Z.Luli përsëri: znj.Shllaku e keni ju të drejtën me sjellë projekt aktin. Pse ia kërkonit administratës?

Z.Shkjau: Edhe unë jam anëtar i këtij komisioni dhe shumë raste po bëhet bujë për këtë komision. Ky komision është vendosur nga vetë Këshilli, dhe është e drejta jonë të kërkojmë llogari pasi kemi punuar për këtë. Për më tepër është e disata herë që diskutohet dhe akoma nuk ka kaluar në Këshill për miratim.

Vijohet me votimin e rendi i ditës, ku rezultojnë **27** vota Pro **0** Kundër **9** Abstenim. **Miratohet**

Po ashtu para se të kalohet tek pikat e rendit të ditës vijohet me miratin e procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara të Këshillit Bashkiak:

*Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 18.12.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet***

*Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 29.12.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet***

Kalohet tek pika e parë e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2025”.*

Kjo pikë nuk ka nevojë për relativim, prandaj kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pike 2.: *Projektvendim: “Për miratimin e Kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfutuese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6 %) për ndihmën ekonomike”.*

Edhe kjo pikë nuk ka nevojë për relativim, prandaj kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e tretë e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Znj. Daniela Jakoja”.*

Znj.Gjekaj në cilësinë e kryetares së komisionit të mandateve, relaton sipas materialit të përgatitur dhe fton kolegët këshilltarë ta votojnë këtë projektakt.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Z.Luli fton **znj.Jakoja** të bëjë betimin, sipas formulës së betimit të lexuar nga ai.

Vijohet me pikë 4. të rendit të ditës: *Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër”.*

Z.Luli sqaron se kjo pikë vjen si rezultat i vakancës së krijuar në Këshillin e Qarkut Shkodër pas dhënies së dorëheqjes së Znj.Nika. Ai fton këshilltarët të bëjnë propozimet e tyre, dhe shton se votimi do bëhet në fund të rendit të ditës, për arsye që të operojmë me përgatitjen e dokumentacionit, i cili të do të jetë lista e votuesve, si edhe fletët e votimit me propozime të kandidatëve përkatës.

Z.Bjanku merr fjalën dhe thotë se për pjesën e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Qarkut, mirë do të ishte që të vendosim disa kritere. Nëse ne vendosim disa kritere, edhe ne si grup që jemi në minorancë mund të propozojmë kandidaturën tonë. Besoj që në qoftë se arrijmë që të vendosim disa kritere, që mund t'i kemi në diskrecionin tonë, pas të cilave para se të kalojmë tek procedura, ne të mund të dalim me kandidaturën tonë.

Z.Luli sqaron se në bazë të rregullores janë tre persona të cilët përjashtohen nga kandidimi, që është kryetari dhe dy nënkryetarët. Ndërsa gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit bashkiak janë të barabartë, kështu që mos të ndërtojmë kritere të cilat nuk i ka përcaktuar rregullorja. E vetmja mënyrë është kjo me konsensus. Kjo është procedura që kemi zhvilluar edhe me datën nëntëmbëdhjetë qershor, nëse ju kujtohet, prandaj po zbatojmë të njëjtën procedurë, siç kanë zhvilluar të gjitha këshillat e tjerë.

Znj Rraboshta merr fjalën dhe shprehet se si grup kemi rënë dakord që këtë vakancë ta plotësojmë me këshilltarin më të vjetër, që ka pesë mandate që është anëtar i këtij Këshilli bashkiak, prandaj kërkojmë mbështetjen e gjithëve.

Z.Erkoçaj: Unë propozoj Zotin Muharrem Shkjaun për të qënë pjesë e Këshillit të Qarkut.

Z.Luli, Atëherë, meqënëse propozime të tjera nuk ka, sekretaria administron dy propozimet. Do përgatisim dokumentacionin dhe menaxhimi i procesit të votimit dhe numërimit do bëhet nga komisioni i mandateve me kryetare zonjën Gjekaj, Zotin Ndoj dhe Znj.Rusi, që nuk është. Si rrjedhojë dy anëtarët prezent do ta menaxhojnë procesin e votimit.

Znj.Gjekaj merr fjalën dhe shprehet se duke qënë se po evidentoj tani që zonja Rusi mungon, dhe duke qënë se duhet patjetër me ligj që të jemi numër tek. Atëherë mendoj se duhet të bëhet një propozim nga opozita që ta zëvendësojnë, sepse nuk mundemi dot të monitorojmë dhe aq më tepër të numërojmë votat, duke qënë dy persona, dhe aq më tepër që jemi në të njëjtën parti politike, të të njëjtit grup politik.

Z.Luli sqaron se sipas rregullores, komisioni i mandateve menaxhon edhe procesin e votimit dhe të numërimit. Dhe në këtë rast, shumica është e plotësuar, pra, korumi me dy vetë. Në qoftë se kemi diçka tjetër, atëherë po propozojmë komision votimi, ku secili nga grupimet propozon nga një anëtar që tre grupimet të jenë të përfaqësuar.

Znj.Gjekaj përsëri thotë se komisioni i mandateve i ka anëtarët e vet dhe duhet të jenë të tre prezent. Në momentin e këtij rasti që ne kemi votim, numërim të votave, duhet patjetër që numri të jetë tre. Meqë mungon Izmira, duhet ta zëvendësojë dikush tjetër nga opozita.

Z.Luli thotë se në këtë rast, nuk kemi braktisje nga zonja Ulqinaku. Kemi mungesë nga ana e saj. Korumit i komisionit është present, prandaj nuk besoj se ka pengesa në këtë rast. Nuk mundet as ta zëvendësojmë sepse nuk kemi të bëjmë me shkarkim. Unë bëra edhe një propozim që të kemi komision të votimit. Secili prej grupimeve të propozoi një anëtarë.

Znj.Gjekaj, jo nuk ka nevojë të krijojmë asnjë komision votimi, sepse do të menaxhohet nga komisioni i mandateve.

Kalohet tek pika 5. e rendit të ditës: *“Për miratimin e shitjes të mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik si automjet në terësi, si dhe automjeteve dhe materialeve që përmbajnë hekur me procedurë ankandi publik për skrap”*.

Relaton për këtë pikë **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme juridike në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje nuk ka, kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **23** vota Pro **0** Kundër **9** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *“Për një ndryshim në VKB nr.27 datë 01.06.2016 “Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar ”*.

Relaton për këtë pikë **Z. Laço**, drejtor i përgjithshëm i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z. Galiqi merr fjalën duke u shprehur që sigurisht, nuk ka kundërshtim për këtë fakt, as për këtë komision. Gjithmonë jam entuziast i ndërtimit të një komisioni të tillë, shton ai por për ne do të ishte e rëndësishme të kemi një feedback nga anëtarët e komisionit, mbi punën që kanë bërë dhe mbi raportet që kanë pas edhe me zyrën e kulturës. Po e hedhi si propozim unë, madje nuk është e domosdoshme ajo punë, po një feedback duhet të ishte me vlerë, për të parë se sa rentabël ka qenë dhe sa janë marrë në konsideratë sugjerimet e këtij komisionit, në raport me zyrën e Kulturës së Bashkisë.

Përgjigjet **Znj.Smaja**, drejtoreshë Kulture në Bashkinë Shkodër, duke sqaruar se anëtarët e komisionit janë vendimarrës për të gjitha projektet që vijnë. Domethënë, nuk është thjesht feedback apo kërkim mendimi. Ata marrin vendimet se cilat nga projektet kalojnë për zbatim.

Z.Bjanku: nëse është kaq thjesht, okej, por ne në historinë tone dhe me ç'po e diskutojmë, propozimi është i Bashkisë. Në fakt mund të ishte edhe propozimi jonë me anëtarët e këtij komisionit, por përgjithësisht diskutimet lidhen edhe me faktin që në historinë e këtij këshilli, kemi patur edhe anëtarë që janë larguar me arsyetimin se s'është marrë në konsideratë mendimi i tyre. Nuk po bëj avokatin e djallit, po thjesht. dua të zgjoj një diskutim, që këto anëtarë të komisionit sa merren në konsideratë në vendimarrje. Sa është ndikuar dhe cilat përzgjedhje ka bërë. Ky është shqetësimi.

Përsëri **Znj.Smaja** përgjigjet: Anëtarët e komisionit janë të njëjtët që ishin dhënë mandatin e kaluar dhe përderisa të gjithë kanë qenë shumë dakord që të jenë prapë në, do të thotë se nuk ka pakënaqësi. Thjesht është rinovim i mandatit.

Znj.Shala: Është e vërtetë që anëtarët e Këtij Këshilli janë figura të nderuara të qytetit por ky komision mbylli dyvjeçarin e parë dhe ne nuk kemi pasur diçka, qoftë një raport vjetor, ose diçka

që tregon veprimtarinë e tyre gjatë këtyre dy vjetëve dhe për mendimin tim reale në vendimarrje këtu nuk ka. Ne shohim që përzgjedhja dhe miratimi është një miratim politik, pra ky komision mbetet gjithmonë nën kontrollin e ekzekutivit, qoftë edhe për zgjedhjen e anëtarëve, nuk ka një pikëzim, nuk ka propozime. Vijnë këtu me një diçka të kryer, pra hajde ta kalojmë dhe ta miratojmë. Prandaj unë mendoj që ndoshta duhet me mendu në të ardhmen, me paraqit mënyrën se si zgjidhen aktivitetet. A ka një rregullore, a ka një standard ky komision? Dhe të na sillet edhe një raport, sepse ne kemi bërë shumë kërkesa, kjo për aktivitetet, koncertet, për shpizat, për shumë gjëra dhe gjithmonë na është thënë në komisionet që është ky këshill që e miraton. Nuk kemi një relacion me mënyrën se si kalojnë dhe si vendosen, si merren këta vendime. Ne kërkojmë që të ketë më shumë transparencë dhe më shumë llogaridhënie në Këshillin Bashkiak prej këtij komisioni.

Znj.Smaja thotë se komisioni gjithmonë në çdo mbledhje që bën, mban proces verbal dhe çdo gjë është transparente.

Z.Bjanku: Atëherë, ndërhyrja ime është kryesisht për procedurën që ka të bëjë me procedurën e votimit. Këto me të vërtetë, secili prej tyre, ka rëndësinë e vet si figura. Por procedura e votimit nuk duhet të jetë në bllok, pra të gjithë njësoj, sepse secili prej këtyre ka një element, ka karakteristika, ka reputacionin të cilin e dallon njërin nga tjetri dhe unë propozoj që votimi të bëhet nominalisht për shkak të cilësive individuale që ka gjithësecili.

Z.Luli sqaron, se kjo është një praktikë që ne nuk e kemi ndjekur asnjëherë në bazë të udhëzimit të nxjerrë. Është numri i përcaktuar shtatë që i përket fushave të ndryshme. Për më tepër këtë propozim duhet ta kishit bërë në komision.

Z.Bjanku: I përmend shumë herë komisionet, por nuk merr përsipër asnjë lloj angazhimi për t'i mbledh këto komisione si kryetar Këshilli.

Përsëri **Z.Luli**, Po s'është detyra ime. Pra, unë nuk jam për të mbledhur komisionet. propozoni që ta ndryshojmë rregulloren, sepse rregullorja thotë në qoftë se komisioni shprehet pozitivisht, negativisht ose nuk mbledhet, kjo nuk ndalon kalimin e aktit në mbledhje të Këshillit.

Z.Bjanku: Ka prevalencë ligji, ligji i përmbledh dhe i përkufizon komisionet dhe përgjithësisht janë detyruese. Nuk është vullnetare mbledhja e komisionit.

Kalohet tek mendimet e Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë Z, Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse Znj.Shestani shprehet se; dëshiroj të sqaroj diçka, ne nuk jemi kundër atyre individëve, të cilët janë përfaqësues të denjë të Shkodrës për kulturën, për sportin, ne jemi kundër komisionit që nuk jep llogari, që është pra pallogaridhënie. Që nuk kemi garanci, që nuk është i varur prej ekzekutivit, pra jemi kundër fenomenit që ky komision rrezikon të kthehet një instrument politik dhe asnjë gjë më shumë. Prandaj grupi jonë politik abstenon.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **28** vota Pro **0** Kundër **9** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e radhës: “ *Për një ndryshim në VKB nr.18 datë 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Nësia administrative Gur i Zi, fshati*

Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Vitalia Albanie” i ndryshuar.

Relaton për këtë pikë **Znj,Shllaku** drejtoreshë Mjedisit në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.I.Sokoli: Për procedurë, ideja është që ky vendim, dakord, ne mund të jemi pro. vazhdimi të kontratës, por çwshtja i paplotë si vendim, sepse ne nuk kemi shifrën e qiramarrjes për vitin që shtohet. Pra, në vendim duhet të shtohet shifra e qiramarrjes për vitin e tretë. Në momentin që në vendim do jetw shifra e qeramarrjes, patjetër që ne do e votojmë pro.

Pwrgjigjet **Znj. Shllaku:** Atëherë, vendimi i Këshillit të Bashkisë, të cilit ne i referohemi, është vendimi numër tetëmbëdhjetë, dy mijë e njëzetë e tre. Ky vendim ka përcaktuar masën e qirasë, afatin e kontratës dhe sipërfaqen. Ne kemi ndryshuar vetëm pikën tre të vendimit, afatin nga njëzet e katër muaj në tridhjetë e gjashtë muaj, pra qeraja është e përcaktuar e pandryshuar. Për këtë vendim wshtw lidhur një kontratë qiraje, wshtw lidhur një amendim kontrate. Është e paguar qiraja vjetore, qiraja është nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind lekë të reja.

Z.I.Sokoli: Në vit, jam dakord, por gjëja është që qeraja është dhënë për një periudhë dyvjeçare, jo trevjeçare, ne duhet patjetër që të kemi edhe qeranë për vitin e shtyrjes dhe kjo duhet të jetë në vendim, kaq e thjeshtë është.

Kalohet tek mendimet e Kryetarëve të grupeve, ku Z. Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse Znj.Shestani shprehet abstenim.

Pr/akti hidhet në votim. **Nuk Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore “Rosek Rrjoll” Bashkia Shkodër”.*

Relaton përsëri **Znj,Shllaku** drejtoreshë Mjedisit në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Golemi merr fjalën dhe pyet nëse nga kjo zonë aktualisht merren të ardhura? Dhe a keni kërkesa për t'i marrë me qira këto zona që është nxjerrë kjo shifër që shohim në materialin e paraqitur? Po ashtu ato zona a janë aktualisht kullota?

Përgjigjet **Znj,Shllaku,** Shifra nxirret në bazë të bagëtive që mund të ketë zona që merren nga Instati dhe nga kërkesa, sepse këto bagëti do të lëshohen për të kullotur. Fshatarët do të paraqesin kërkesën, t'i kenë bagëti të regjistruara në sistem. Merret informacioni, shikohet sa bagëti janë dhe në bazë të numrit të bagëtive, jepet sipërfaqja me qira në bazë të tarifave.

Pyetje e diskutime të tjera për projektaktin nuk ka, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 9. :*Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*.

Kjo pikë nuk ka nevojë për relatin, siç është rënë dakord. Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e radhës: *Raport mbi punën e Këshillit Bashkiak për 12 - mujin e vitit 2025.*

Raport ky që relatohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak.

Fjalën e merr **Znj.Gjekaj**: Duke qenë se pjesë e bazës ligjore është edhe karta e autonomisë vendore për të zgjedhurit vendor. Unë do kisha dashur që mos të përsëritet ose të jemi më të vëmendshëm në lidhje me respektimin e Kartës së Autonomisë Vendore. Pasi në vitin që i lamë pas, kemi patur kërkesa të këshilltarëve, të cilëve nuk i është rimbursuar shpenzimet për aktivitetet që kanë patur. E para dhe e dyta, duke qenë se ne miratojmë në buxhet një shumë të caktuar për vizita studimore për anëtarët e këshillit, i bie që për vitin që lamë pas, ne nuk kemi bërë asnjë vizitë studimore për anëtarët e këshillit nuk kemi bërë as trajnime për anëtarët e këshillit. Këshilli jonë nuk ka pak anëtarë, të cilët janë për herë të parë këtu dhe duke qenë se janë për herë të parë pa diskutim, që është e nevojshme që të bëhen trajnime të vazhdueshme apo vizita studimore për atë kohë kur ne kemi në dispozicion edhe një shumë jo të vogël për t'i shpenzuar për këto vizita studimore. Po ashtu, do kisha dashur të vë në vëmendje edhe një proces të fundit të 2024, kur bëhet një vizitë studimore ose kur bëhet një vizitë për shkëmbim eksperiencës. Nuk duhet të veprohet si në këtë rast ku vetëm përfaqësues të grupit politik të Partisë Socialiste nuk kanë qenë. Nuk e di kush i ka përfaqësuar anëtarët e Partisë Socialiste, sepse asnjëri prej nesh nuk ka qenë tek ai aktivitet, tek shkëmbim eksperiencash. Dhe do doja që mos të përsëritej më, sepse kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e rregullores.

Sqaron këtu **Z.Luli** duke thënë se Përfaqësues nga ana e grupit të Partisë Socialiste ka qenë zoti Ndou, i cili për arsye objektive nuk ka marrë pjesë në këtë vizitë studimore, ndërsa nga gjitha grupet e tjera politike kanë marrë pjesë në atë vizitë studimore, siç duhet në lidhje me qëllimin e saj. I gjithë materiali është i arshivuar pranë Sekretarisë së Këshillit. Kështu që besoj që kjo është përgjigja për sa i përket vizitës studimore. Për më tepër ky ka qenë vendimi i kryesisë.

Fjalën e merr edhe **Znj.Duhani**, e cila shprehet në lidhje me vizitën që është bërë në vitin 2024, unë kam qenë ajo që e kam organizuar, sepse kam gjetur një ofertë që na kanë bërë për binjakëzim. Personat që kanë marrë pjesë janë përfaqësues të grupeve, nënkryetarët e këshillit. Nga grupi i Partisë Socialiste përfaqësues, kanë qenë kryetari Z.Luli dhe Z. Ndou, të cilët në moment të fundit, pasi ishin bërë procedura me tenderim, siç është e kërkuar, nuk patën mundësi të merrnin pjesë. Gjithashtu, dua të theksoj vitin e kaluar ka ardhur një kërkesë tjetër për binjakëzim, e cila nuk është marrë në konsideratë. Edhe të themi të drejtën, kemi bërë një figurë jo të bukur përpara bashkisë, e cila nuk ka marrë përgjigje fare. Shpresojmë që këtë vit të na bashkoni fondet e vitit të kaluar, të cilat me sa di unë mund t'i trashëgojmë dhe të bëjmë diçka.

Z.Bjanku: Atëherë këtu bëhet fjalë për punën e Këshillit, zoti kryetar. Dhe mendoj që një veprimtari dymbëdhjetë mujore që përcillet me tre fletë nuk është serioze. Kështu që besoj që ky raport njëvjeçar ka jashtëzakonisht shumë mangësi. Kjo nuk është normale dhe duhet që të krijojmë një tjetër standard etik, moral, profesional dhe çdo gjë tjetër, që para këshillit të jemi më korrekt. Ky raport që një prej fletëve është vetëm bazë ligjore dhe pjesa tjetër ka dy-tre fjali, nuk është normale.

Përsëri **Z.Luli** shprehet se raporti ka gjashtë fletë saktësisht, zoti Bjanku dhe është modeli që kanë sjellë Bashkitë e Forta. Është praktikë që njihet në gjithë këshillat bashkiak. Në qoftë se ti ke ndonjë propozim në lidhje me numrin e fletëve, nga tri, gjashtë, tetë, nëntëmbëdhjetë, mund ta propozosh. që ta kemi në konsideratë për herën tjetër këtë kërkesë të tuajën, edhe ndaj Këshillit, po dhe ndaj Bashkive të Forta si sugjerim për lënë zhurmë.

Ky raport hidhet në votim ku rezultojnë **27** vota Pro **7** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika shtesë e rendit të ditës: *“Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2026”, pikë kjo që nuk ka nevojë për relativim. Kryetarët e grupeve, të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.*

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Zv/Kryetarja e Bashkisë **Znj.Qyteza** merr fjalën dhe shprehet: Dua t’iu falenderoj të gjithëve për miratimin në mënyrë unanime. Dua të falenderoj gjithashtu grupin e punës që ka punuar me seriozitetin më të madh, me transparencë, me të gjithë grupin. Edhe komisionin e strehimit që është marrë në mënyrë ekskluzive me këtë dokumentacion, me këto dosje, me këto tabela, me këto kriterë në mënyrën më të mrekullueshme. Dhe me shumë lumturi them që ndoshta për herë të parë kemi tejkalu të gjitha kuotat, i kemi përmbushur më shumë se njëqind për qind, duke pas mundësi të realokojmë edhe një fond të mbetur nga viti i kaluar. I gëzofshin të gjithë qytetarët tanë dhe i falenderojmë shumë për besimin që kanë te Bashkia Shkodër.

Kalohet tek pika e fundit shtesë : *Për miratimin e projektit “Sunny Schools”, të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA dhe Bashkia Shkodër, i cili përfshin instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Salo Halili” dhe “Ndoc Mazi.*

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Golemi**; Doja të dija pse janë përcaktuar këto tre shkolla. Dhe në qoftë se shohim dy shkollat, të cilat do financohen nga OSFA., që është shkolla “Ndre Mjeda” me një sipërfaqe

gjashtëqind e pesëdhjetë e një metër katror dhe shkollës “Salo Halili“, një mijë e shtatë metra katror, pra një mijë e gjashtëqind të dyja bashkë. Dhe vlera totale e projektit është njëzet e një mijë euro, afërsisht. Ndërsa përsa i përket shkollës “Ndoc Mazi“, që ka tetëqind metra katror, pra është gjysma e sipërfaqes së këtyre dy shkollave, vlera e projektit që do financohet nga Bashkia është shtatëmbëdhjetë mijë euro, pra është e përafërt. Edhe po ta shohim nga numri i nxënësve përsëri mendoj që mund të kishte një shkollë tjetër me numër më të madh nxënësish për të cilën mund të financonte ky projekt?

Përgjigjet këtu në mënyrë të detajuar **Z.Mema**.

Z.I.Sokoli: Ajo që unë shoh këtu është që në fakti që shkolla Ndre Mjeda është një projekt i ri, i restauruar, i rikonstruktuar. Dhe nuk duhet të ishte këtu, pra duhet të ishte bërë sistemi i paneleve fotovoltaike me rehabilitimin e plotë shkollës. Projekti i rehabilitimit është i paplotë, sepse ne nuk kemi panelet fotovoltaike për të reduktuar si kostot e energjisë apo si edhe emetimet e CO2. Ndërkohë, përsa i përket këtij vendimit që na ka ardhur, ju nuk keni të kalkuluar as reduktimin e faturave të energjisë për secilën shkollë, nuk keni të kalkuluar me sipërfaqen e paneleve për secilën shkollë. Dhe nuk keni të kalkuluar dhe reduktimin e CO2, pra përfitimet dhe justifikimin për sa i përket reduktimit të CO2. Ajo që unë ftoj të bëjmë është që meqë ju nuk keni një projekt për sa i përket projektit ër shkollën Ndoc Mazi, atëherë duhet ta ndajmë në dy vendime, Ndre Mjeda dhe Salo Halili bashkë dhe Ndoc Mazi të jetë i veçuar, sepse duhet të kalojnë në tenderim për projekt zbatim dhe më pas duhet të vijë për projekt zbatim për projektin.

Përsëri **Z.Mema** shprehet se ne kemi aplikuar për atë që ka pas mundësi edhe donatori me dhënë. Pra, normalisht, edhe termat referencë edhe thirrjet që ka pas donatori kanë qenë tilla. Është që ne e kuptojmë normalisht, inxhinierët përkatë se dinë shumë më mirë se sa është nevoja dhe sa duhet me kenë sipërfaqja paneleve, gjë e cila nuk besoj se duhet me kenë relacionar në projektvendim. Në momentin që po marrim një donacion nga një donator i huaj për një projekt që është aplikuar.

Znj.Shestani: Atëherë unë kam dy pyetje, sa lekë kursehen në këto shkolla? Më mirë të themi për sa vite amortizohet ky investim dhe ku shkojnë kursimet e energjisë elektrike prej këtyre, të paneleve? A hyjnë në rrjet apo përdoren vetëm te shkolla, apo ça prodhohet më tepër. Ajo që më intereson është sa kursehet në vit. Po për amortizimin, defektet kush i paguan nesër? Dhe a janë llogaritë këta gjëra, se kanë kosto?

Përgjigjet **Z. Mema** përsëri duke thënë se po e përsëris, që është një donacion edhe një grand që jepet nga OSFA . Këto nuk arrijnë të mbulojnë të gjithë nevojën për energji të këtyre shkollave. Kështu që do të jetë një analizë që do të bëhet në përfundim. Pra, së paku për të parë edhe diferencën që ekziston ndërmjet sa është paguar më përpara ose sa paguhet tani.

Më hollësisht sqaron edhe **Z.Shllaku**, drejtoreshë Mjedisë në Bashkinë Shkodër.

Z.Bjanku: Kam një pyetje në lidhje me një qytetar më shkruan, por nuk e kam informacion timin, shkruan se në shkollën N. Mjeda është realizuar një investim më përpara, apo është ky ?

Përgjigjet **Z. Mema:** Po kemi realizuar një pjesë, ndërsa pjesa tjetër do të realizohet me këtë fazën e dytë. Nuk kemi lënë atë sipërfaqe që kërkohet sepse shkolla Ndre Mjeda ka ngrohje me chiller.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **28** vota Pro **6** Kundër **3** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek votimi për përfaqësuesin e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut Shkodër.

Votim ky që kryhet i fshehtë siç e parashikon rregullorja. Nga ky votim rezulton që nuk ka asnjë kandidat fitues.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 26.01.2026. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban ____faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ



KRYETAR

Oltion LULI



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

